



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0483

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T.SH. " AR - DRITI ", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunes Flamurtari me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1, me 14/08/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH. " AR - DRITI " me nr. 2026/0483 , e datës 10/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunes Flamurtari me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndertimi i tribunes Flamurtari me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- Komuna Prishtinë të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh.nr.2026/0275 i datës 21.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i tribunes Flamurtari" me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1.
4. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës., që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh.nr.2026/0275 i datës 21.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i tribunes Flamurtari" me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1.
5. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP, anulimin e licencës për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit të AK-së /Komuna e Prishtinë, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.
6. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.T.SH. " AR - DRITI "

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.01.2026. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i tribunes Flamurtari” me nr. të prokurimit: "616-26-258-5-2-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontrates: 142,733.21 €.

Me 23.06.2026. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënje të kontrates ku është rekomanduar për kontratë “ACHGroup SH.P.K.; Papi.S Construction SH.P.K,

Me 26.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 03.07.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.07.2026, OE “ AR - DRITI "ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0483, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhenje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ AR - DRITI "janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 Qëllimi Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, Neni 51 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, si dhe Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë Dosja e tenderit - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 • Neni 4.3 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik • Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik As njoftimit për dhënien e kontratës me Rivlerësim të datës 02.06.2026, konform ligjit për qasje në dokumente zyrtare, kemi bërë kërkesë pranë AK-Komuna e Prishtinës, e cila na ka lejuar qasje dhe kanë qenë shumë korrekte gjatë procedurës. Ku me datën 02.07.2026 është refuzuar kërkesa për rishqyrtim nga AK, edhe pse për këtë Aktivitet të Prokurimit Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë vendim me numër 2026/0275, me anë të së cilit ka miratuar ankesën si të bazuar edhe e ka kthyer lëndën në Rivlerësim me datën 21.05.2026. Pas analizës detale nga ekspertët e prokurimit nga kompania jonë, kemi gjetur shumë mangësi në vlerësim të ofertës nga ana e komisionit. Sipas analizës

sonë, rezulton që grupi OE DachGroup SH.P.K. & Papi.S Construction SH.P.K. është si ofertë e papërgjegjshme konform të kërkesave të dosjes së tenderit. Sipas kërkesave dosja pika 8.1 dhe 8.2: 1. Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale, ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 Euro (60% Bartësi i konzorciumit). 2. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo konfirmimin nga banka për qarkullimin e kërkuar. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. Pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti Teknik dhe Profesional 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlerë minimale prej 200.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë). (60% Bartësi i konzorciumit). 2. Dëshmia - Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. PREZANTOJMË FAKTET: Gjatë analizimit të kontratave të ofruara në Aneksin 6, kemi gjetur si në vijim. Grupi OE në listën e projekteve ka ofruar kontratën: 1. Ndërtimi i parkut afër objektit të Komunës së Mitrovicës Veriore në rrugën Çlirimi, nuk gjendet në listën e projekteve të paraqitur nga OE dhe raporti teknik i kësaj kontrate është i përkohshëm dhe nuk i përmbush kërkesat nga AK. 2. Ndërtimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë, nuk ka pranim teknik të nënshkruar nga komisioni dhe OE nuk është lider i kësaj kontrate dhe ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. 3. Pika 1 në listën e projekteve: “Renovimi i shkollave fillore të mesme të ulëta në Fushë Kosovë dhe fshatra” - ky projekt është në listën e projekteve, por nuk është e paraqitur kontrata dhe vetëm një referencë. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. 4. Sipas listës së Projekteve nga OE pika nr. 2 “Renovimi i rrethojave të SHFMU Laura Skoti në fshatin Grabovc të Poshtëm dhe SHFMU Vëllezërit Frashëri në Miradi të Epërme” - nuk e ka prezentuar kontratën, vetëm një raport teknik - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. 5. Pika 3 në listën e projekteve: “Renovimi i hapësirave të spitalit (lot 2 Renovimi i objekteve të administratës)” - ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një raport të pranimi teknik - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. 6. Pika 4 në listën e projekteve: “Rikonstruktimi i hapësirës publike në rrugën Egnatia, Lagjja Ulpiana” - ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një certifikatë të pranimi të përkohshëm - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK. Të gjitha projektet e paraqitura nga OE në listën e projekteve - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur dosjen e tenderit dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërkesë nga AK - të gjitha projektet e paraqitura ku OE nuk është lider në asnjë projekt, sipas kërkesës në FTD, ku lideri është dashur të përmbushë së paku 60% të vlerës. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. 5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira. 6. Te kjo kërkesë kemi të gjetur se grupi OE DachGroup SH.P.K. & Papi.S Construction SH.P.K. ka dështuar në listën e pajisjeve të kërkuara: Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Albi Trans 2023 L SH.P.K., ku ka prezentuar faturën me nr. 25-

SHV01-001-5 dhe DUD-in doganor, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërke nga AK. Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Burimi E SH.P.K., ku ka prezentuar faturën me nr. 15/2022 nga MANI SH.P.K. dhe faturën me nr. 20/2024 nga FATMIR X BOSHNIJAKU B.I. dhe DUD-at doganorë, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërke nga AK. Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezentuar një marrëveshje huazimi me Varna SH.P.K., ku ka prezentuar kontratën për shitblerjen dhe DUD-in doganor, por nuk ka paraqitur faturën dhe dëshminë e pagesës bankare - ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërke nga AK. 4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9, 12, 13). 5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira. Te kjo kërkesë kemi gjetur se Grupi OE DachGroup SH.P.K. & Papi.S Construction SH.P.K. nuk i ka përmbushur kriteret në dosjen e tenderit 7/3. Sipas dëshmimeve të paraqitura nga OE, certifikata nga DOQANLED nuk i plotëson kërkesat e paraqitura nga AK, pasi që ne konsiderojmë ky dokument është jo valid dhe përmban shënime shumë të pakta dhe jo konkrete. Dhe në autorizimin e EURO ON GROUP SH.P.K. të paraqitur nuk janë të cekura në autorizim pika 12 dhe 13. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushje e kësaj kërke nga AK. Pasi që në FTD është kërkuar që të jetë autorizimi valid për pozicionet e caktuara. Ndërsa për autorizimin nga prodhuesi Yucel Bahce kërkojmë që të verifikoni nga prodhuesi nëse ky autorizim është valid, pasi ka mundësi që të bëhen manipulime në mënyrë digjitale të nënshkrimit, pasi në autorizim nuk ka asnjë informatë mbi të dhënat e biznesit, ku duhet të ketë ndonjë informatë mbi kontaktin e autorizuesit e që në këtë rast mungojnë dhe si të tillë e konsiderojmë të nevojshme dhe të obligueshme që të bëhet verifikimi në mënyrë që të validohet autorizimi, përndryshe ky autorizim konsiderohet i pavlefshëm. Këto fakte të prezantuara janë mjaftueshëm të evidentueshme që të konkludohet që ky Grup OE është i papërgjegjshëm dhe nuk plotëson kërkesat në FTD dhe në Njoftimin për Kontratë. 9/3 Ne kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve të bëhet konform dispozitave të Nenit 59 të LPP-së, sepse në të kundërtën do të bjerë ndesh me fushëveprimin e LPP. AK duhet të anulojë vendimin e dhënë dhe të aprovojë kërkesën tonë për rishqyrtim. Në bazë të sqarimeve dhe fakteve të prezantuara më lartë, kërkojmë nga AK që ta aprovojë kërkesën tonë duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura, shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, dhe provat që ju kemi ngarkuar dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim, pasi që ne jemi kompania që i plotësojmë të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK. Ne kemi plotësuar të gjitha pikat sipas FTD-së, andaj edhe kërkojmë të rishqyrtohet edhe njëherë ky vendim, andaj bazuar në faktet e lartëcekura më lartë kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ta detyrojë AK ta zbatojë plotësisht vendimin e saj të datës 21.05.2026. Për këtë Aktivitet të Prokurimit Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë vendim me numër 2026/0275, me anë të së cilit ka miratuar ankesën si të bazuar edhe e ka kthyer lëndën në Rivlerësim. Autoriteti Kontraktues në rivlerësim prapë ka propozuar GOE të njëjtë për kontratë, duke mos marrë fare parasysh argumentet tona edhe njëherë, duke e mos përfillur edhe vendimin e OSHP-së. **VENDIM I. APROVOHET** si e bazuar kërkesa e OE NTSH AR-DRITI, dhe lënda të kthehet në II. **RIVLERËSIM** gjatë rivlerësimit të shpërblehemi me kontratë, pasi që i plotësojmë të gjitha kriteret e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë, pasi që jemi OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë, i plotësojmë kriteret e kërkuara të FDT-së dhe të Njoftimit

për Kontratë/Dosje të Tenderit, dhe ne si OE duhet të ? SHPËRBLEHEMI me kontratë për këtë aktivitet, pasi që jemi OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "NTSH AR-DRITI" (tutje "parashtruesi") me datë 26.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-26-258-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (in meritum) të kërkesës. Pretendimet ankimore të parashtruesit: Faqe 1 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 visar.shehu@rks-gov.net TITULLI I KONTRATËS DATA E NËNSHKRIMIT DATA E PËRFUNDIMIT Vlera e kontratës EMRI I BLERËSIT NR. TELEFONI/EMAILI I BLERËSIT 1. Renovimi i Shkollave Filllore të Mesme të Ulëta në Fushë Kosovë dhe fshatra 04.10.2023 242,242.00 Komuna Fushë Kosovë 038/20040511, 038/20040512, bedri.oberlinca@rks-gov.net 2. Renovimi i Rrethojave të SHFMU "Sami Skoti" në Bhatin Graboc të Poshtëm dhe SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Miradi të Epërme 16.04.2024 Komuna Fushë Kosovë 038/20040511, 038/20040512 3. Renovimi i hapësirave të Spitalit (Lot 2 - Renovimi i objekteve të administratës) 08.01.2024 10.2024 191,970.00 Spitali i Përgjithshëm Pejë 049 738 623, veton.jahmurataj@gmail.com 4. Rikonstruimi i hapësirës publike në Rrugën Egnatia 01.10.2024 Komuna Prishtinë 5. Ndërtimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë në Fushë Kosovë 2025 538,228.09 Komuna Fushë Kosovë 038/20040511, 038/20040512 Gjatë analizimit të kontratave të ofruara në aneksin 6, kemi gjetur si në vijim. Grupi OE në listën e projekteve ka ofruar kontratën: 1. Ndërtimi i parkut afër objektit të komunës së Mitrovicës Veriore në rrugën Çlirimi, nuk gjendet në listën e projekteve të paraqitur nga OE dhe raporti teknik i kësaj kontrate është i përkohshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK. Faqe 2 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 visar.shehu@rks-gov.net 2. Ndërtimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë në Fushë Kosovë, nuk ka pranim teknik të nënshkruar nga komisioni dhe OE nuk është lider i kësaj kontrate dhe ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkeje nga AK. 3. Pika 1 në listën e projekteve: "Renovimi i shkollave filllore të mesme të ulëta në Fushë Kosovë dhe fshatra". Ky projekt është në listën e projekteve, por nuk është e paraqitur kontrata dhe vetëm një referencë. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkeje nga AK. 4. Sipas listës së projekteve nga OE, pika nr. 2 "Renovimi i rrethojave të SHFMU Laura Skoti në fshatin Graboc të Poshtëm dhe SHFMU Vëllezërit Frashëri në Miradi të Epërme" - nuk e ka prezantuar kontratën, vetëm një raport teknik. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkeje nga AK. 5. Pika 3 në listën e projekteve: "Renovimi i hapësirave të spitalit (Lot 2 - Renovimi i objekteve të administratës)" - ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një raport të pranimi teknik. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkeje nga AK. Faqe 3 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 6. Pika 4 në listën e projekteve: "Rikonstruktimi i hapësirës publike në rrugën Egnatia, Lagjja Ulpiana" - ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një certifikatë të pranimi të përkohshëm. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkeje nga AK. Të

gjitha projektet e paraqitura nga OE në listën e projekteve - ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur dosjen e tenderit dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK-së - të gjitha projektet e paraqitura ku OE nuk është lider në asnjë projekt, sipas kërkesës në FTD, ku lideri është dashur të përmbushë së paku 60% të vlerës. 5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. 5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira. 6. Te kjo kërkesë kemi gjetur se grupi OE DachGroup SHPK & Papi.S Construction SH.P.K. ka dështuar në listën e pajisjeve të kërkuara. Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Albi Trans 2023 L SH.P.K., ku ka prezantuar faturën me nr. 25-SHVO 1-001-5 dhe dudit doganor, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK. Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Burimi E SH.P.K., ku ka prezantuar faturën me nr. 15/2022 nga MANI SH.P.K. dhe faturën nr. 20/2024 nga FATMIR XH. BOSHNJAKU B.I. dhe dudit doganor, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK. Një ekskavator deri në 5.5 t - ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Varna SH.P.K., ku ka prezantuar kontratën për shitblerjen dhe dudit doganor, por nuk ka paraqitur faturën dhe dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK. 4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi, specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9, 12, 13). 5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira. Te kjo kërkesë kemi gjetur se Grupi OE DachGroup SHPK & Papi.S Construction SH.P.K. nuk i ka përmbushur kriteret në dosjen e tenderit. Faqe 4 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 visar.shehu@rks-gov.net Sipas dëshmive, certifikata nga DOGANLED nuk i plotëson kërkesat e paraqitura nga AK, pasi që ne konsiderojmë ky dokument është jo valid dhe përmban shënime shumë të pakta dhe jo konkrete. Dhe në autorizimin e EURO ON GROUP SH.P.K. të paraqitur nuk janë të cekura në autorizim pikat 12 dhe 13. Ne konsiderojmë se OE nuk i ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK, pasi që në FTD është kërkuar që të jetë autorizimi valid për pozicionet e caktuara. AUTHORIZATION Date: 05/02/2026 To whom it may concern, We, EURO ON GROUP SHPK, hereby officially authorize DACHGROUP SH.P.K., with headquarters in Prishtina, Republic of Kosovo, to use/represent, and include our products which we are authorized dealer for Kosovo from Kolayllk Elektrik Sanay ve Ticaret AS. company in the tender procedure for the following project; Project title: Construction of the "Flamurtari" Stadium Tribune Procurement Number: 616-26-258-5-2-1 Contracting Authority / Investor: Municipality of Prishtina This authorization is issued for the purpose of participation in the above-mentioned public procurement procedure and allows DACHGROUP SH.P.K. to submit our product catalogues, technical documentation, certificates, and all relevant materials related to EURO ON GROUP SHPK products. We confirm that the products offered under this authorization are original and comply with applicable European standards and technical requirements requested in the tender dossier. This authorization is valid exclusively for the above-mentioned project and tender procedure. Should you require any further information or

verification, please do not hesitate to contact us. Sincerely, EURO ON GROUP SHPK Ndërsa, për autorizimin nga prodhuesi Yucel Bahce, kërkojmë që të verifikoni nga prodhuesi nëse ky autorizim është valid, pasi ka mundësi që të bëhen manipulime në mënyrë digjitale të nënshkrimit, pasi në autorizim nuk ka asnjë informatë mbi të dhënat e biznesit ku duhet të ketë ndonjë informatë mbi kontaktin e autorizuesit e që në këtë rast mungojnë dhe, si të tillë, e konsiderojmë të nevojshme dhe të obligueshme që të bëhet verifikimi në mënyrë që të validohet autorizimi, përndryshe ky autorizim konsiderohet i pavlefshëm. Faqe 5 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 visar.shehu@rks-gov.net [Autorizimi] Faqe 6 nga 7 "UÇK" nr. 2, Prishtinë Tel.: 038-200-40-111 Parashtruesi ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim. Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT-së, si dhe specifikat teknike të DT-së. Pra, vlerësimi i bërë nga komisioni vlerësues është i saktë në tërësi. Po ashtu, është konfirmuar fakti që parashtruesi ka dorëzuar ofertë më të shtrenjtë sesa tenderuesi i rekomanduar. Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, par. 63.1.1, nënparagrafin b), lidhur me nenin 62, par. 62.1, nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, par. 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.07.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0483 ndërsa me datë 24.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0483, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “ AR - DRITI "eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0483 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 483/26 kane të bëjë me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ku sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me përvojën e OE në fushë specifike (kontrata të ngjashme).Eksperti shqyrtues sqaron se për të njëjtin aktivitetin të prokurimit, kemi trajtuar paraprakisht ankesën nga i njëjti OE ankues, ku kemi rekomanduar të aprovet ankesa pjesërisht, duke rekomanduar që AK të kërkojë sqarime shtesë për kontratat e kontesutuara nga OE ankues.

Në raportin 275/26 decidivisht kemi rekomanduar që :

“ Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, dhe rekomandon që me rastin e rivlerësimit AK të kërkojë informata shtesë dhe të pranohen vetëm projektet/kontratat e përfunduara (realizuara në tërësi), po ashtu të kërkojë sqarim për kontratat ku OE ka qenë anëtar i grupit të sqarohet se sa ka qenë pjesëmarrja/kontributi i OE në fjalë për atë projekt dhe vlera e referencës të llogaritet sipas pjesëmarrjes. Po ashtu të kërkojë plotësim i dokumenteve në pajtim me LPP për projektet për të cilat nuk është ofruar kontratë fare”.

Pas dorëzimit të raportin 275/26 OSHP ka nxjerr vendimin me nr.275/26 ku paneli shqyrtues ka konstatuar se :

“Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ju fal besimin e plotë, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie të kontrates dhe lenda të kthehet në rivlerësim. Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor sa i përket falsifikimit secila palë në procedurë por edhe AK konform nenit 52.7 të LPP mund të ju drejtohet organeve përgjegjëse, ngase, OSHP nuk ka as kapacitete teknike dhe as profesionale ta bëjë një verifikim të tillë”.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, nuk ka gjetur dëshmi se AK ka ndërmarr veprimet për sqarimin e pikave ashtu siq është kërkuar në raportin e ekspertit dhe vendimin e OSHP-së i cili bazuar në raportin ekspertit shqyrtues.

AK as në vendimit të tij ndaj kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhënë sqarime apo kunderargument lidhur me kontratat e kontestuara.

Në rastin konkret eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së nr.275/26, andaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimorë janë pjesërisht të bazuara, dhe rekomandon që lenda të kthehet në rivlerësim duke zbatuar vendimin e OSHP-së 275/26.

Sa i përket pretendimeve për “manipulim” të autorizimeve/dokumente, eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi kapacitet profesional e as kompetencë për tu përgjigjur në pretendim të tillë ankimorë, ndërsa OE ankues për të njëjtat mund të drejtohet organeve kompetente.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit. Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit dhe konstaton se lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2026/0275, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - “Komuna e Prishtinës”, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjate vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e kanë respektuar në përpikëri Vendimin e OSHP- së nr. 2026/0275 të datës 21.05.2026, ku AK pasi që ka kthyer lëndën në ri-vlerësim, nuk ka vepruar konform rekomandimeve në vendim, por kanë vazhduar me duke e bërë të njëjtin veprim. Me këtë rast AK në këtë rast ZPP ka vepruar në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP, konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin Publik.

Me çrast OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - “Komuna e Prishtinës”, që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të veprojnë sipas nenit 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - “Komuna e Prishtinës”, në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Kjo nuk është hera e parë që Komuna e Prishtinës/Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i zbaton vendimet e OSHP, me çrast OSHP disa herë ballafaqohet me përsëritje të ankesave dhe pretendimeve të njëjta nga palët. Këto veprime janë në kundërshtim fillimisht me neni 1 të LPP, duke prolonguar qëllimisht aktivitetet e prokurimit, po ashtu janë në kundërshtim edhe me nenin 6 dhe 7 të LPP.

Njëherit, sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: “Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”. Në

bazë të sqarimeve të lartpërmendura, edhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet prap si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe rrejdimit vendos që aktivitetin e prokurimit me titull: “ Ndertimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit: "616-26-258-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ta kthej në ri-vlerësim.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.T.SH. " AR - DRITI "**
- Arkivës së OSHP-së: